



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:107989

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05655538

KA.nr.204/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Stella” SH.P.K., me seli në Gjakovë rruga “Wesley Clark”, duke përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Arbër Guta nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, përfaqësuar sipas autorizimit nga Vjollca Shyti, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 14/355/01-1141 të datës 17.01.2023 të Inspektoratit të Shërbimeve Publike dhe Vendimit Nr. 14-352/012490 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave , pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik më datë 04.04.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit sipas autorizimit avokat Arbër Guta dhe përfaqësuesit të palës së paditur Vjollca Shyti, më datë 12.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit “Stella” SH.P.K., me seli në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës.
- II. **ANULOHET** Vendimi Nr. 14/355/01-1141 i datës 17.01.2023 i Inspektoratit të Shërbimeve Publike dhe Vendimi Nr. 14-352/012490 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

## Historiku procedural

1. Më datë 15.05.2023, në Gjykatën Komerciale të Kosovës Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Stella” SH.P.K., me seli në Gjakovë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. KA.nr. 204/23, kundër të paditurit Komuna e Gjakovës, për shkak të anulimit të Vendimit Nr. 14/355/01-1141 i datës 17.01.2023 i Inspektoratit të Shërbimeve Publike dhe Vendimit Nr. 14-352/012490 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, me propozim që gjykata të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës me numër 14-352/01-2490 si dhe me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.
2. Me aktvendim të datës 17.05.2023 është aprovuar si e bazuar kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kundërshtuara, deri në vendim përfundimtar përkitazi me kërkesëpadinë.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Arbër Guta, sipas autorizimit sipas autorizimit të datës 05.02.2023 dhe të përfaqësuesit të palës së paditur Vjollca Shyti sipas autorizimit të datës 26.10.2023.

## Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit kryesorë si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi NN “Stella” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për leje të përdorimit të objektit të ndërtuar me ç’rast Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit tutje DUMM nxjerr aktvendim Nr. 07/351-81058 të datës 09.12.2015 me të cilin parashtruesit të kërkesës i jepet leja e përdorimit për objektin e stacionit të derivateve pompës për karburante të ndërtuar. Në kuadër të marrjes së lejes ndërtimore dhe lejes për përdorim ndër kriteret e përcaktuara nga DUMM, kishte qenë edhe pajisja me pëlqim për kyçje në rrugë regjionale, të cilën e prekte edhe parcela e paditëses dhe si rrjedhojë e kësaj paditësjë është e pajisur edhe me pëlqimin për kyçje. Objekti i ndërtuar nga “Stella” SH.P.K., në kohën e marrjes së lejeve është bërë në ngastrën 4408/64 ZK Gjakovë jashtë qytetit e cila ngastër aktualisht është bashkuar nën numrin e ngastrës 5826. Ndërkaq parcelat 4408/8, 4408/9, dhe 4408/10 për të cilat

paditësja ka marr pëlqim për kyçe tani janë zëvendësuar dhe gjenden nën numrin 4408/68.

5. Ka theksuar se, më datë 30.11.2022 Inspektorët e Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës kanë kryer inspektim në pompën e benzinës “Stela” SH.P.K., ndërsa më datë 13.01.2023, Inspektorët e Shërbimeve Publike kanë pranuar ekspertizën e përpiluar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gjakovës, në të cilën është përshtetur se parcela me numër 4408/64 ZK Gjakovë jashtë qytetit është në pronësi të 1/1 Pronë shoqërore. BVI rrugë regjionale, ndërsa më datë 17.01.2023, Inspektorati i Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës, nxjerr vendim me të cilin e urdhëron G.P. si person fizik dhe jo personit juridik tani paditëses “Stella” SH.P.K., që në afat prej 10 ditëve të bëhet largimi i të gjitha pengesave si shtyllat elektrike, panot reklamuese, pishat dhe një objekt me konstruksion hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate, ndërsa më datë 24.02.2023, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, nxjerr vendim me të cilin i refuzon ankesat e parashtruara nga “Stella” SH.P.K.
6. Ka shtuar se, vendimi me numër 14-352/01-2490 i datës 24.02.2023, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave është derivat i vendimit me numër 14/355/01-1141 i cili përmban të meta formale në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 48 par. 1, nenit 87 dhe nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, tutje LPPA, si vendim i pa arsyetuar dhe i paligjshëm. Në arsyetimin e vendimit të Komisionit, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se bazuar në ekspertizën e datës 10.01.2023, mungesës së pëlqimit për shfrytëzim të sipërfaqes publike nga organi kompetent komunal, dhe duke u bazuar në nenin 75 par.3 të Rregullores Nr, 352/01-22518/2018, për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal, ndërsa kjo rregullore është në kundërshtim të plotë me Ligjin për Rrugë dhe Ligjin për Plotësim dhe Ndryshim të Ligjit për Rrugë i cili ligj qartë ka përcaktuar vëllimin e kompetencave komunale, lokale dhe atyre qendrore, përkatësisht në nenin 3 është përcaktuar decidivisht se Ministria është përgjegjëse për auto udhë, rrugë nacionale, rajonale dhe për rrugët lidhëse që lidhen me këto rrugë dhe rrjedhimisht ngastra e paditësit e cila ka dalje në ngastrën 4408/64, është ngastër e cila bie në kompetencë të Ministrisë, andaj Inspektorët e Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës si dhe Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kanë vepruar në tejkalim të kompetencave të përcaktuara me ligj si dhe paligjshmëria e këtij vendimi bazohet edhe në nenin 52 par.1.1

dhe 1.2 të LPPA-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës me numër 14-352/01-2490.

### Kundërshtimet e të paditurës

7. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi, deklarimeve gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, procedura për lirimin e hapësirës pran organit administrativ të paditurës ka filluar mbi bazën e ankesës së qytetarit në përputhje me nenin 72 par. 1 i Rregullores Nr. 352.01-22518/208 për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal. Bazuar në dispozitat e kësaj rregulloreje Inspektorët e Shërbimeve Publike kanë urdhëruar paditësin që brenda afatit prej 190 ditësh të bëj largimin e të gjitha pengesave shtyllat elektrike, panot reklamuese, pishat, si dhe një objekt me konstruksion prej k=hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate në sipërfaqen publike rrugë në parcelën 4408/68 ZK Gjakovë., jashtë qytetit që është në pronësi të 1/1 Psh.BVI në rrugën Wesley Park. Po ashtu edhe sipas ekspertizës së datës 10.01.2023, në të cilën është konstatuar se parcela kadastrale 4408-68 ZK Gjakovë është në pronësi të PSH BVI rrugë Regjionale Prishtinë, për të cilën sipërfaqe paditësi nuk ka prezantuar pëlqim për shfrytëzim të sipërfaqes publike nga organi kompetent komunal.
8. Ka shtuar se, Komuna e Gjakovës ka kompetencë të plotë dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, në fushat e planifikimit urban dhe rural shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, dhe Inspektorët e Shërbimeve publike kanë për detyrë dhe obligim ti kryejnë detyrat konform kësaj rregullore dhe se qytetarët e kanë për obligim që për çdo shfrytëzim të sipërfaqes të marrin pëlqim nga organi kompetent Komunal i Komunës së Gjakovës, ndërsa e paditura ka vepruar konform dispozitave ligjore me rastin e marrjes se vendimit, se objekti kontestues gjendet brenda qytetit të Gjakovës dhe si i tillë bie në kompetencë të saj, I ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Stella” SH.P.K., si të pa bazuar.
9. Plotësimi i fjalës përfundimtare i dorëzuar në gjykatë me datë 11.04.2024 është dorëzuar pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me datë 04.04.2024 dhe si i tillë është i pa papranueshëm.

## Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi nr.14-352/012490 i datës 24.02.2023, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, Vendimi nr. 14-355/01-1141 i datës 17.01.2023 i Inspektoratit të Shërbimeve Publike, Certifikata e regjistrimit të “Stella” SH.P.K., me nr. identifikues 810235110, Aktvendim nga drejtorja e Inspektoratit të KGJ ME NUMËR rendor 14/361-13647 i datës 27.07.2014, Aktvendim mbi legalizimin e objektit të ndërtuar të stacionit të derivateve me nr. 7/351-573 i datës 24.12.2012 nga Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, Aktvendimi leje përdorimi me nr.rendor 07351-81058 i datës 09.12.2015, procesverbal me numër 354 i ndërtimit më datë 21.11.2014, pëlqimi për kyçje në rrugën magjistrale në 9.1 Klinë Gjakovë me numër të referencës 592 më datë 03.09.2012, Historiati i parcelave me numër 4408/68, 4408/64, 5826, 4408/55, 4408/9, 4408/10, 4408/11 ZK Gjakovë, më datë 03.05.2023, Konstatim i datës 10.02.2023, Kopje e planit e datës 24.07.2012 për parcelën 4408, Aktvendim nga ZK Gjakovë me numër të referencës 270/22 i datës 11.01.2022, Ekspertizë e datës 10.01.2022 për parcelat 5826, 4408/55 dhe 4408/68, Përgjigje në kërkesë 2031 nga MMPH me nr. 2084 e datës 21.02.2023, Kërkesa për lirim të pronës publike, rrënimin e ndërtimeve në rrugën Vesfiklaj.
11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.
12. Nga Vendimi nr.14-352/01-2490 i datës 24.02.2023, i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave, është refuzuar si e pa bazuar ankesat me numër 14-352/11-2490 e datës 02.02.2023, 14-352/11-2278 e datës 01.02.2023, 14-355/01-2494 e datës 02.02.2023, 14-355/01-2491 e datës 02.02.2023, të gjitha këto të parashtruara nga “Stella SH.P.K., dhe mbete në fuqi vendimi me numër 14-355/01-1141 i datës 17.01.2023 i nxjerr nga Inspektorët e Shërbimeve Publike në Drejtorinë për Inspektim në

Komunën e Gjakovës, me arsyetim se Inspektorët pas vlerësimit të ekspertizës të datës 10.01.2023, në të cilën është konstatuar se parcela kadastrale 4408-68 ZK Gjakovë jashtë qytetit është në pronësi të 1/1 PSH BVI rrugë Regjionale Prishtinë për të cilën sipërfaqe pala ankuese tani paditës nuk ka prezantuar pëlqim për shfrytëzim të sipërfaqes publike nga organi kompetent komunal. Bazuar në dispozitat ligjore të rregullores Nr. 352/01-22518/2018, për shërbimet publike dhe rendin komunal ndalohet shfrytëzimi i rrugëve, trotuareve, dhe sipërfaqeve tjera publike pa pëlqimin e organit kompetent komunal dhe se për shfrytëzimin e përkohshëm të trotuareve dhe sipërfaqeve tjera publike, pa pëlqim të organit kompetent dhe se për shfrytëzim të përkohshëm të trotuareve apo hapësirave publike vendos organi kompetent komunal me lëshimin e pëlqimit, për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirës/lokacionit sipas kriterëve të përcaktuara. Duke u bazuar në nenin 75 par. 3 i Rregullores Nr. 352/01-22518/2018 për shërbimet publike dhe rendin Komunal.

13. Nga Vendimi nr. 14-355/01-1141 i datës 17.01.2023 i Inspektoratit të Shërbimeve Publike, është urdhëruar G.P. që brenda 10 ditësh nga pranimi i kësaj urdhërese që të bëj largimin e të gjitha pengesave si shtyllat elektrike, panot reklamuese, pishat si dhe objekt me konstruksion prej hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate në sipërfaqen publike rrugë në parcelën 4408-68 ZK Gjakovë, jashtë qytetit, në pronësi të 1/1 PSH BVI në rrugën “Ëesley Clark”, me arsyetim se Inspektori i shërbimeve Publike pas pranimit të lëndës 14/354/01-27237, ka kryer inspektim sipas detyrës zyrtare në rrugën Ëesley Park, përkatësisht në pompën e benzinës Stella SH.P.K., ku ka vërejtur se në rrugën e përshkruar Z/G.P., ka vendosur shtyllat elektrike, panot reklamuese, pishat si dhe objekt me konstruksion prej hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate. Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike është kërkuar nga drejtoria për kadastër dhe pronë që të bëj ekspertizë, ku më datë 13.01.2023 Inspektoret e Shërbimeve Publike kanë pranuar ekspertizën në të cilën është përshkruar se [parcela me numër 4408-68 ZK Gjakovë, jashtë qytetit është në pronësi të 1/1 PSH BVI .
14. Nga Certifikata e regjistrimit të Stella SH.P.K., me nr. identifikues 810235110, “Stella” SH.P.K., është regjistruar si biznes më datë 06.02.2004, me numër unik identifikues 810235110, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Me Aktvendim nga Drejtoria e Inspektoratit të Komunës së Gjakovës, me numër rendor 14/361-13647

i datës 27.07.2014, i është lejuar G.P.t si pronari i firmës N.T “Stella” SH.P.K., shfrytëzimi në rrugën “Ëesley Park”, për kryerjen e veprimtarisë.

15. Nga Aktvendimi mbi legalizimin e objektit të ndërtuar të stacionit të derivateve me nr. 7/351-573 i datës 24.12.2012 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, i është legalizuar G.P.t ndërtimi i objektit të stacionit të derivateve pompës për karburante, në ngastrën kadastrale me numër 4408/64 ZK Gjakovë jashtë qytetit, objekt i ndërtuar në sipërfaqe prej 371.88 m2. Pas pranimit të aktvendimit për legalizim, investitori është obliguar që të aplikoj për leje përdorimi të objektit bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 2004/15 nenit 49-52.
16. Nga pëlqimi për kyçje në rrugën magjistrale në 9.1 Klinë Gjakovë me numër të referencës 592 më datë 03.09.2012, Ministria e Infrastrukturës-Komisioni i Drejtorisë së rrugëve e ka pajisur aplikuesin tani paditës “Stella “ SH.P.K., me pëlqim për kyçje në rrugën magjistrale Nm91 drejtimi Klinë Gjakovë, në ngastrat kadastrale nr. 4408/9, 4408/10, 4408/11, 4408/64ZK Gjakovë, i cili pëlqim vlen vetëm për lejimin e fillimit të punëve, ndërsa pas përfundimit të punëve, pala duhet të parashtoj kërkesë për pranim të kyçjes në rrugë, në Ministrinë e Infrastrukturës.
17. Aktvendim leje përdorimi me nr. Rendor 07351-81058 i datës 09.12.2015, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e ka pajisur me leje përdorimi aplikuesin tani paditësin “Stella” SH.P.K., për objektin e stacionit të derivateve pompës për karburante ndërtuar në rrugën “Ëesley Park”, në ngastrën kadastrale 4408/64 ZK Gjakovë.
18. Nga procesverbal me numër 354 i ndërtimit më datë 21.11.2014, Drejtoria e Innspektionit të Gjakovës, mbi kryerjen e kontrollit inspektues më datë 21.11.2014 inspektorët kanë konstatuar se, pronari ka të ndërtuar objektin stacion i derivateve dhe posedon lejen e legalizimit të objektit në hapësirën me numër 4408/64.
19. Nga Historiati i parcelave me numër 4408/68, 4408/64, 5826, 4408/55, 4408/9, 4408/10 ,4408/11 ZK Gjakovë, më datë 03.05.2023, është konstatuar ndër të tjera se në vitin 2020, ne baze te Kontratës së dhurimit, LRP, nr. rendor 2493/20,ref.nr. 633/20,dt. 21.07.2020, parcela nr. 4408/67, prej: G.Xh.P., kalon ne posedim te “Stella” SH.P.K. Ne vitin 2020, sipas kërkesës nr. 16960/20 është bere bashkimi i

parcelave nr. 4408/67 dhe 4408/68 dhe është formuar parcela e re me nr. 5806, kulturë jo-pjellore ne sipërfaqe prej 0.41.74 ha në posedim te “Stella” SH.P.K. Ne vitin 2022 sipas kërkesës nr. 270/22 është bere bashkimi i parcelave me nr: 4408/17, 4408/19, 4408/47, 4408/48, 4408/49 ,4408/56 ,4408/57, 4408/59, 4408/60, 4408/66, 5806 dhe është formuar parcela e re me nr. 5826, kulturë jo-pjellore ne sipërfaqe prej 0.76.29 ha, ne posedim 3/12 “Stella” SH.P.K,9/12 N.T. “Stella” SH.P.K. Kjo gjendje mbetet e pa ndryshuar deri ne ditën e sotme.

20. Konstatim i datës 10.02.2023, nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër është konstatuar formimi i parcelave si kanë konstatuar se parcela kadastrale me nr. 5826-0 Zk. Gjakove Jashtë Qytetit është formuar me bashkimin e parcelave kadastrale 4408-17, 4408-19, 4408-47, 4408-48, 4408-49, 4408-56, 4408-57,4408-58, 4408-59, 4408-60, 4408-66 dhe 5806-0 në bazë te kërkesës nr. 270/22 dt.06.01.2022. Gjithashtu vlen te përmendet që parcela kadastrale 5806-0 ZK. Gjakove Jashtë Qytet është formuar me bashkimin e parcelave kadastrale 4408-67 dhe 5718-7, në baze te kërkesës nr. 16960/20. Parcela kadastrale 4408-68 është formuar nga nr. parcelave kadastrale 4408-10 Zk. Gjakove jashtë Qytet. Parcela kadastrale 4408-10 është aktiv ne baze te kërkesës 604/15. Kopje e planit e datës 24.07.2012 për parcelën 4408/9, 4408/10, 4408/11.
21. Aktvendim nga ZK Gjakovë me numër të referencës 270/22 i datës 11.01.2022, nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, është aprovuar kërkesa e Geo Kad SH.P.K. për “Stella” SH.P.K., që ka të bëjë me bashkimin e njërive kadastrale, si 04408-17, 04408-19, 04408-47, 04408-48, 04408-49, 04408-56, 04408-57, 04408-58, 04408-59, 04408- 60, 04408-66, 50806-0 në vendin e quajtur Gjakovë, Jashtë Qytetit.
22. Ekspertizë e datës 10.01.2022 për parcelat 5826, 4408/55 dhe 4408/68, Me date 21.12.2022 me kërkesën e drejtorisë për pune inspektuese është bërë dalja në terren për matjen e gjendjes faktike, respektivisht te hapësirës e cila shtrihet ne kuadër te parcelave kadastrale 5826-0, 4408-55, 4408-68. Sipas operatit kadastral parcela kadastrale 5826-0 Zk. Gjakove Jashtë Qytet është ne pronësi te 1/1 N.T. "Stella" SHPK., pc.nr. 4408-55 ZK. Gjakove Jashtë Qytet është ne pronësi te 1/1 Shfrytëzues: L.Th. dhe parcela kadastrale 4408-68 Zk. Gjakovë Jashtë Qytet qe është ne pronësi te 1/1 PSH. BVI, për Rruge Regjionale Prishtine. Pas marrjes së detyrës nga ana e inspektoratit është bërë matja e gjendjes faktike e cila ne ekspertize është



paraqitur me ngjyrë të kuqe, si dhe hapësirat gjelbëruese të cilat i kemi paraqitur me ngjyre të gjelbër.

23. Përgjigje në kërkesë 2031 nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. 2084 e datës 21.02.2023 nga Departamenti i Infrastrukturës kemi konfirmimin lidhur me ngastrën kadastrale 5826-0, zona kadastrale Gjakove jashtë qytetit në rrugën “Wesley Clark”, e cila ka dalje direkte në rrugën Nacionale N9. me nr. të parcelës 4408-68 e cila evidentohet në emër të PSH.BVI për Rruge regjionale Prishtine Rruga Nacionale N9.1, është rrugë që menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës. Andaj, në bazë të nenit 3 të ligjit Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rruge NR. 2003/11. Kanë informuar që Ministria është përgjegjëse për autoudhë, rruge nacionale, rajonale dhe për rrugët lidhëse që lidhen me këto rruge në pajtim me nenin 18.1 të Ligjit dhe rrjedhimisht ngastra në fjale bie në kompetencë të Ministrisë.
24. Kërkesa për lirim të pronës publike, rrënimin e ndërtimeve në rrugën Vesniklaj, shtetasi L.Th. nga Gjakova, ka parashtuar kërkesë për lirim të pronës publike rrënimin e ndërtimeve në rrugën “Wesley Clark” me propozim që të rrënohet objekti pa leje të ndërtimit i ndërtuar në rrugën “Wesley Clark”, gjegjësisht asetet e personit juridik “Stella” SH.P.K.

#### Baza Ligjore

25. Ligji Nr. 2003 / 11 Ligji për Rrugët, neni 5 përcakton se “Ministria është autoritet për rrugë publike magjistrale e regjionale” 5.2. “Komuna është autoritet për rrugë publike lokale dhe ato në vendbanime”, lidhur me Ligjin Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11, neni 3 përcakton se Neni 5 paragrafët 5.1 dhe 5.2 ndryshohen si vijon 5.1 *Ministria është përgjegjëse për autoudhë, rrugë nacionale, rajonale dhe për rrugët lidhëse që lidhen me këto rrugë në pajtim me nenin 18.1 të ligjit.* 5.2 *Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale në pajtim me nenin 18.1 të ligjit, Neni 29 paragrafi 1 përcakton se “Kur ndërtimi, struktura, instalimi, shenja ose qasja në rrugën e vendosur është ndërtuar në tokë në kundërshtim me këtë Ligj ose rregullat e kushtet e përmbajtura në leje, Ministria duhet të kërkojë nga pronari që ta lëvizë, largojë, ose ndryshojë ndërtimin, strukturën, instalimin, shenjën ose qasjen në rrugë”*, paragrafi 2 i të njëjtit nën përcakton se “Vërejtja sipas paragrafit 1 të këtij neni lëshohet në formë të shkruar dhe i dorëzohet pronarit ose pronarëve personalisht”.

26. Ligji për Rrugët Nr. 2003/11, jep përkufizimet si ne vijim: “Autoriteti i Rrugës Publike” e ka kuptimin e autoritetit administrativ përkatës të emëruar nga Ministria për rrugë magjistrale dhe regjionale dhe Komuna për rrugë lokale dhe rrugë në vendbanime; “Rrugë Regjionale” e ka kuptimin e një rruge publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë regjionale, që lidh dy e më tepër qytete të mëdha; “Rrugë Lidhëse” e ka kuptimin e një rruge që lidh stacionet hekurudhore, aeroportet, терминаlet ose hapësirat e banimit me rrugët publike që është e njohur zyrtarisht nga Ministria si e tillë; “Rrugë Lokale” e ka kuptimin e rrugës publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune.

27. Ndërsa, sipas Ligji Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë Nr. 2003/11, neni 1 Në përkufizim dhe në tërë tekstin e ligjit fjala “rrugë magjistrale” zëvendësohet me fjalën “rrugë nacionale”. “Rrugë nacionale” nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës; “Rrugë publike” nënkupton sipërfaqen me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, e cila mund të shfrytëzohet nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent; “Rrugë urbane” nënkuptohet rruga publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune. “Rrugë rajonale” nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve. “Rrugë lidhëse” nënkupton rrugën publike e cila lidh vendbanimet me stacionet hekurudhore, rrugët për aeroport, banjë shëruese, qendra rekreative parqet nacionale etj.

#### Vlerësimi i gjykatës

28. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Çështja kontestuese në këtë konflikt administrativ është vlerësimim i kompetencës së Komunës për lëshimin e Vendimit Nr. 14/355/01-1141 i datës 17.01.2023 i Inspektoratit të Shërbimeve Publike dhe Vendimit Nr. 14-352/012490 i datës 24.02.2023 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave që ka të bëjë me menaxhimin e parcelës kadastrale 4408-68 Zk. Gjakovë Jashtë Qytet ne pronësi te 1/1 PSH. BVI.

29. Gjykata vlerëson se më datë 30.11.2022 Inspektorët e Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës kanë kryer inspektim në pompën e benzinës “Stela” SH.P.K., ndërsa më datë 13.01.2023, Inspektorët e Shërbimeve Publike kanë pranuar ekspertizën e përpiluar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Gjakovës, në të cilën është përshkruar se parcela me numër 4408/64 ZK Gjakovë jashtë qytetit është në pronësi të 1/1 Psh.BVI rrugë regjionale-Prishtinë, ndërsa më datë 17.01.2023, Inspektorati i Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës, nxjerr vendim me të cilin e urdhëron G.P. si person fizik dhe jo personit juridik tani paditëses Stella SH.P.K., që në afat prej 10 ditëve të bëhet largimi i të gjitha pengesave si shtyllat elektrike, panot reklamuese dhe një objekt me konstruksion hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate, ndërsa më datë 24.02.2023, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, nxjerr vendim me të cilin i refuzon ankesat e parashtruara nga Stella SH.P.K
30. Gjykata vlerëson se me Ligjin Nr. 2003 / 11 për Rrugët rregullohet pozita juridike e rrugëve publike, ndërtimi, mirëmbajtja e rrugëve, masat mbrojtëse, qeverisja, financimi dhe mbikëqyrja e rrugëve publike, ndërsa në nenin 3 të Ligji nr. 03/1-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11 është përcaktuar se 5.1 Ministria është përgjegjëse për: autoudhë, rrugë nacionale, rajonale dhe për rrugët lidhëse që lidhen me këto rrugë në pajtim me nenin 18.1 të Ligjit. 5.2 Komuna është përgjegjëse për rrugët lokale në pajtim me nenin 18.1 të Ligjit.
31. Gjykata gjen se, organi i paditur me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar është bazuar në ekspertizën e datës 10.01.2022, të Drejtorisë për Punë Inspektuese për parcelat 5826, 4408/55 dhe 4408/68, ku është konstatuar se parcela kadastrale 4408-68 ZK Gjakovë jashtë qytetit është në pronësi të 1/1 PSH BVI, Rrugë Regjionale-Prishtinë, dhe duke urdhëruar G.P. që brenda 10 ditësh nga pranimi i kësaj urdhërese që të bëj largimin e të gjitha pengesave si shtyllat elektrike, panot reklamuese, pishat si dhe objekt me konstruksion prej hekuri që shërben për tu furnizuar me derivate në sipërfaqen publike rrugë në parcelën 4408-68 ZK Gjakovë, jashtë qytetit, në pronësi të 1/1 PSH BVI në rrugën “Ëesley Clark”, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit Nr. 2003 /11 për Rrugët dhe Ligjit Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugë nr. 2003/11, ngase me rastin e nxjerrjes së vendimit i ka tejkaluar kompetencat dhe autorizimet ligjore të parapara me këtë ligj.

32. Gjykata vlerëson se neni 29 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët në paragrafin 1 përcakton se “kur ndërtimi, struktura, instalimi, shenja ose qasja në rrugën e vendosur është ndërtuar në tokë në kundërshtim me këtë Ligj ose rregullat e kushtet e përmbajtura në leje, Ministria duhet të kërkoj nga pronari që ta lëvizë, largojë, ose ndryshojë ndërtimin, strukturën, instalimin, shenjën ose qasjen në rrugë”, bazuar në këtë dispozitë ligjore kompetente është Ministria që të kërkojë nga pronari largimin e instalimin, shenjën ose qasjen në rrugë.
33. Nga kjo rrjedh se pëlqimi për kyçje në rrugën magjistrale në 9.1 Klinë Gjakovë me numër të referencës 592 më datë 03.09.2012, tani paditës “Stella “ SH.P.K., me pëlqim për kyçje në rrugën magjistrale Nm91 drejtimi Klinë Gjakovë, në ngastrat kadastrale nr. 4408/9, 4408/10, 4408/11, 4408/64ZK Gjakovë, i është dhënë nga Ministria e Infrastrukturës-Komisioni i Drejtorisë së rrugëve. Megjithatë, gjykata rikujton se nga përmbajtja e pëlqimit rezulton se aplikuesit tani paditësit “Stella “ SH.P.K i cili pëlqim vlen vetëm për lejimin e fillimit të punëve, ndërsa pas përfundimit të punëve, i njëjti është i obliguar që të parashtrij kërkesë për pranim të kyçjes në rrugë, në Ministrinë e Infrastrukturës. Po që nga shkresat e lëndës rezulton se i mungon pëlqimi për pranim të kyçjes në rrugë dhe që i njëjti parcelën 4408/68 e shfrytëzon pa bazë ligjore. Mirëpo sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët paragrafi 1, (të cituar në paragrafin paraprak) Ministria duhet të kërkoj nga pronari që ta lëvizë, largojë, ose ndryshojë ndërtimin, strukturën, instalimin, shenjën ose qasjen në rrugë që e shfrytëzon në kundërshtim me këtë Ligj ose rregullat e kushtet e përmbajtura në leje.
34. Andaj, gjykata vlerësoi se në gjendjen faktike të konstatuar drejtë e paditura ka aplikuar gabimisht Ligjin material respektivisht Ligjit për Rrugë Nr. 2003/11, me plotësim ndryshimet përkatëse, duke i tejkalluar kompetencal ligjore në baze të nenit 3 te Ligjit Nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rruge NR. 2003/11 Ministria është përgjegjëse për autoudhë, rruge nacionale, rajonale dhe për rrugët lidhëse që lidhen me këto rruge ne pajtim me nenin 18.1 te ligjit dhe rrjedhimisht ngastra ne fjale bie ne kompetence te Ministrisë, e konfirmuar edhe në përgjigje të lëshuar nga departamenti ligjor i Ministrisë, prandaj Inspektorët e Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës si dhe Komisioni për shqyrtimin e ankesave kanë vepruar në tejkallim të kompetencave të përcaktuara me ligj.

35. Vendimi u more bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, neni 16 paragrafi 1.4 dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.204/23, datë 12.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.